



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivary	29 - 11 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtupca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SDM/SHK	7490/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.842/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.842/2022 të datës 03.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi: [redacted] Komuna e

Lipjanit, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.842/2022 e datës 03.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Shfuqizohen Vendimi me numër:647 i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 15.06.2022, si dhe Plotësim Ndryshimi i Aktit Emërimit të ankuesit i nxjerrë me datë 15.06.2022 nga Menaxheri i Personelit.

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmes e-mailit ankesa.kpmsk@rks-gov.net me datë 02.10.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 03.10.2022 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.842/2022 me numër protokollit 5807/2022, me pretendimet ankimore se ankuesi është duke u diskriminuar pasi që për pozitën e njëjtë duhet të jetë edhe niveli i pagës së njëjtë, ngase në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës pozita e Udhëheqësit të Sektorit për Prokurim dhe Udhëheqësit të Sektorit për personel paguhen me koeficient 9.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 10.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 14.11.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.145/2022 përmes të cilit ankesës së ankuesit me shenjën A.nr.842/2022 të datës 03.10.2022 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5807/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 02.10.2022 dërguar nga ankuesi në Këshill me korrespondencën e bashkëngjitur; Formularin e të dhënave për listën e pagave i datës 06.07.2022; Vendimin e datës 08.06.2022 të Zëvendësuesit të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 15.06.2022; E-mailin e datës 02.09.2022 dërguar nga A.T për R.H dhe ankuesin me korrespondencën e bashkëngjitur prej tre (3) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.10.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.11.2022; E-mailin e datës 10.11.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore për Këshillin; Akt emërimit të ankuesit të datës 07.06.2019; Kërkesën e ankuesit të datës 21.05.2021 për nivelizimin e koeficientit; E-mailin e datës 01.02.2019 dërguar nga AA.H për R.H dhe N.K me korrespondencën e bashkëngjitur; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Zbatim të Legjislacionit"; Shkresën e lëshuar nga DASHC/MAP e datës 06.02.2019 me numër:333; Konkursin e brendshëm për pozitën "Udhëheqës i prokurimit"; Akt emërimit të datës 07.06.2019 për zyrtarin G.M; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Menaxher i Personelit si dhe akt Emërimit të datës 07.06.2019 për zyrtarin R.H; Konkursin e datës 22.11.2021 për pozitën udhëheqës i Sektorit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Persona të Mitur.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, **SEPSE:**

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i provave të lëndës, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 07.06.2019 është i punësuar në pozitën *"Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit"* me koeficient 8.5 në kuadër Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 15.06.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:647 përmes të cilit ankuesit ia ka ngritur koeficientin nga 8.5 në 9(nëntë), njëherit i kanë bërë edhe plotësim ndryshimin e Aktit të Emërimit me datë 15.06.2022 duke përcaktuar edhe ngritjen e koeficientit nga 8.5 në 9 (nëntë).

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 06.07.2022 ka bërë ndryshimin në formularin e pagave dhe duke kërkuar nga Thesari i Republikës së Kosovës, që për ankuesin ekzekutimi i pagës të bëhet sipas koeficientit 9 (nëntë), ngase për një gjë të tillë, respektivisht për harmonizimin e koeficient të ankuesit ka nxjerrë Vendim me datë 15.06.2022 Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, njëherit të njëjtë i është bërë edhe plotësim ndryshimi aktit të emërimit me datë 15.06.2022 nga Njësia e Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Mirëpo, Zv. Udhëheqësi i Divizionit të Pagave në Thesarin e Republikës së Kosovës nuk e ka ekzekutuar kërkesën e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës me arsyetimin se ndryshimi i koeficientit të ankuesit nga 8.5 në 9 (nëntë) është kërkesë për avancim, ndërsa në dosje mungojnë procedurat për avancim, dhe për një gjë të tillë duhet të bashkëngjitet aprovimi nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme që pozita e ankuesit apo pozita e Udhëheqësit të njesisë është e barasvlershme me koeficientin 9 (nëntë).

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar shkresën me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike dhe është konstatuar se për pozitën *"Udhëheqës të Sektorit apo Njesisë vendoset koeficienti tetë e gjysmë (8.5) "*, dhe po ashtu edhe me rastin e shpalljes për pozitën të cilën ankuesi e ushtron, Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil përmes shkresës së datës 06.02.2019 me numër:333 e kishte refuzuar kërkesën e institucionit që konkursi për pozitën e ankuesit të aprovohet me koeficient nëntë (9), duke konstatuar faktin se për pozitën *"Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit"* koeficienti është 8.5, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se Thesari i Republikës së Kosovës, respektivisht Divizioni i Pagave ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të ligjit material, ngase në rastin konkret pozita të cilën e ushtron ankuesi paguhet sipas koeficientit 8.5.

Po ashtu, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se i njëjtë është duke u diskriminuar lidhur me pagesën sipas koeficientit 8.5, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë",* sikurse nisur nga fakti se ankuesi ka qenë i emëruar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e

nivelit drejtues një (1) me grada shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018), me LI/090 dhe gradë 7 të pagës, dhe po ashtu edhe përmes shkresës së datës 06.02.2019 me numër:333 Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil e kishte konstatuar faktin se për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Zhvillim dhe Mbikëqyrje të Legjislacionit" koeficienti është 8.5, madje nuk e kishte aprovuar kërkesën e institucionit që për pozitën në të cilën është rekrutuar ankuesi të shpallet sipas koeficientit nëntë (9), andaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar ndërsa Vendimi i nxjerrë nga Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 15.06.2022, sikurse edhe plotësimi dhe ndryshimi i aktit të emërimit të ankuesit të nxjerrë me datë 15.06.2022 nuk janë në harmoni me Legjislacionin përkatës të Shërbimit Civil, ndërsa siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragraf 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material" dhe mbi këtë bazë ankesa e ankuesit është refuzuar si e pa bazuar ndërsa vendimet në fjalë janë shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe pas analizimit e vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sikurse përcaktohet me nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe në mbështetje në nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.842/2022, datë 29/11/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.